

RAPORTI HIDROLOGJIK

**OBJEKTI: “RIKUALIFIKIM I BLOKUT QE KUFIZOHET NGA RRUGET
“MAHMUT ALLUSHI” - “RAMAZAN LICI”- “MUHAMET DELIU” -
“SOTIR CACI”.**

Investitori: Bashkia Tiranë
Studio Projektuese: ZENIT & CO sh.p.k
Vendndodhja: Zona e Freskut

Permbajtja

1. *Hyrje*
- 1.2 *Hidrologjia.*
- 1.3 *Vendodhja e objekteve.*
- 1.4 *Te dhenat e raportit.*
2. *Kushtet klimatike*
- 2.1 *Pozicioni gjeografik.*
- 2.2 *Temperaturat.*
- 2.3 *Rreshjet.*
- 2.3.1 *Rreshjet mesatare*
- 2.3.2 *Rreshjet maksimale*
- 3.1. *Topografia*
4. *Karakteristikat kryesore te rrjedhes se ujit ne pellgun ujembledhes*
- 4.1. *Rrjedhja ujore vjetore*
- 4.1.1 *Prurja mesatare ne aks.*
- 4.2 *Qëndrueshmëria e prurjeve ditore*
- 4.3 *Prurjet Maksimale*
- 4.4 *Rrjedhja e ngurtë*

1. Hyrje

Qellimi i hartimit te ketij raporti eshte te ofroje te dhena mbi hidrologjine e zones ne studim per te marre masa te peshtatshme per kanalizimet qe do projektohen .

1.2 Hidrologjia

Ne kuptimin e saj me te pergjithshem hidrologjia eshte nje disipline shkencore me aplikime te shumta praktike, qe trajton historikun dhe levizjet e ujit ne sistemin atmosferik-tokesor.

Ne nje kuptim me te kufizuar, dhe eshte ky pikerisht ai qe na intereson, mund te themi se hidrologjia eshte nje disipline qe trajton problemet e vleresimit sasior te rrjedhjes se ujit ne siperfaqe e ne brendesi te tokes si edhe lidhjet e kesaj me ujin.

Ne ndertimet ujore e me shume veprave inxhinierike, vleresimi i sakte i sasive te ujit per t'u larguar, i sasive te ujit qe mund te shfrytezohen per nevojat te ndryshme, si dhe levizjes te tij, perbejne probleme te rendesishem, nga zgjidhja e drejte e te cilave varet sukcesi dhe deshtimi i pjesshem, ose i plote i nje vepre.

Kjo e ben te qarte rendesine e madhe te hidrologjise, e sidomos te hidrologjise siperfaqesore qe merret me percaketimin e lidhjeve midis rreshjeve atmosferike dhe rrjedhjes se ujit mbi siperfaqen e tokes, ne forme shtrese ose te kanalizuar. Ne mungese te matjeve, vleresimet hidrologjike bazohen ne rreshjet e pritshme. Nqs ato nuk mund te parashikohen as si sasi e as si intesitet, ato merren nga te dhena te me parshme. Kur keto mungojne meren te dhena nga nje pellg kufitar, ose te larget, me kushte klimatike, topografike dhe gjeologjike, pak a shume te njejta me pellgun ku ndertohet vepra.

1.3 Vendodhja e objektit.

Zona ne studim eshte ajo e Shisht Tufine qe ndodhet brenda Tiranes



Fig.1 Orthofoto e zones

2. Kushtet klimatike

2.1 Pozicioni gjeografik.

Bloku i mare ne studim ndodhet ne zonen e “Freskut” e cila eshte nje nder zonat me te populluara ne qytetin e Tiranës. Elementi kryesor i relievit të zonës në studim, dhe ai malor .

Konfiguracioni orografik i zonës në paraqitet kryesisht malor, me vargmale të ashpër dhe me lugina të thella. Zona në studim përbehet nga formacione gëlqerore, shtresor të çara dhe me formacione alveroite ranore, mergele dhe pak gëlqerore (flishe). Këto janë dy formacionet gjeologjike dhe hidrogjeologjike që përbëjnë pellgun ujëmbledhës të zonës në studim. Në zonën në studim kanë përhapje brezi i tokave të kafenjta nga 600 deri në 1000 m të vendosura me kushtet e klimës mesdhetare në ndikime kontinentale. Mbi lartësinë 1000 m shtrihen tokat e murrme pyjore ato janë formuar mbi shkëmbinjtë e llojeve të ndryshëm dhe në kushtet e një klime të ftohtë dhe nën pyjet e ahut dhe haloreve.

Mbulesa bimore e zonës në studim është e përbërë nga formacione të ahut të cilat janë të zhvilluara në formacione sedimentare (terrogjene gëlqerore). Në lartësitë mbi 1200 m dhe deri në 1400 m takohen livadhe Zona në studim përshkohet nga rrugë automobilistike Tiranë – Burimas – Guri I bardhë – Klos. Gjithashtu nga rruga automobilistike Elbasan – Labinot – Fushë Mal, qafa Rinas – Bizë dhe vazhdon në Bulqizë.




Fig.4 Harta Klimatike e Zones se pellgut ujembledhes ne pjesen e sipërme

Per te dhene nje analize me te detajuar te kushteve klimatike te ketij pellgu, jane shqyrtuar serite klimatike te stacionit te Dajt Rezervuar (980 m mbi nivelin e detit), Petrele (320 m mbi nivelin e detit), te Shengjinit (825 m) dhe Killojke (645m mbi nivelin e detit) per nje periudhe 30 vjecare.Keto stacione ndodhen ne pellgun ujembledhes te marre ne shqyrtim ose jane shume prane ketij pellgu duke bere qe te dhenat e tyre perfaqesojne mjaft mire kushtet klimatike te zones.

2.2. Temperaturat.

Temperatura mesatare vjetore shkon nga -6 deri në 10°C. Minimumet absolute lëvizin në intervalin -15 deri në -30°C në dimra të ashpër.

Ditët e akullta (nën temperaturë zero gradë) shkojnë nga 120 deri në 200 ditë në vit.

Reshjet janë elementi më i theksuar, sidomos për pjesën perëndimore ku ato arrijnë deri në 2000 m në vit.

Erërat që mbizotërojnë janë ato të veriut, verilindja dhe juglindja. Studimi i temperaturës së ajrit në zonën në studim është bërë duke u mbështetur në analizën e vlerave mesatare shumëvjeçare, dhe vlerave ekstreme të vendmatjes meteorologjike Bizë me lartësi +1200m m.n.d.

Nga tabela nr. 1 që jepen temperaturat mesatare mujore dhe vjetore rezulton se për vendmatjen meteorologjike Bizë, për 40 vitet e fundit, muaji më i ftohtë është Janari ku temperature është -2.7°C. Muaji më i nxehtë është Korriku 32.5°C, ndërsa temperature më e ulët absolute -30.2°C në muajin Janar. Kjo është dhe temperatura më e ulët e vendit.

Tabela Nr. 1 Temperatura e ajrit. vendmatja meteorologjike Bizë

Emërtimi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Temp. mesatare	-2.7	-2.5	0.3	5	9.6	12.6	15.2	14.8	12.1	7.8	2.5	-0.7	5.6
Temp. mes max	2.8	2.8	5.6	10.4	15.4	18.8	22.6	22.2	19.4	14.1	7.7	4.2	12.2
Temp mes min	-8.3	-7.8	-5.2	0.3	3.8	6.5	7.8	7.4	4.8	1.5	-2.7	-5.6	0.2
Temp max abs	12.3	12.5	17.5	21	24	31.5	32.5	30	29	25.5	17.5	15	32.5
Temp min abs	-30.2	-28.8	-26.6	-11	-4	-2.2	0.4	0.4	-2	-10.8	-21	-23.4	-30.2




Fig. 5 Temperaturat mesatare mujore, vendmatja Bizë

2.3. Rreshjet.

Nga vete relievi i ketij pellgu ujembledhes, i cili arrin deri ne lartesine mbi 1000 metra mbi nivelin e detit, si dhe distances se tij nga deti, rezulton qe sasia e rreshjeve qe bien ne kete pellg te kete luhatje te medha.

Siç tregohet dhe në figurën Nr. 4 shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka formën “U” që është tipike e një regjimi Mesdhetar të reshjeve. Sasia më e madhe e reshjeve pritët gjatë periudhës së ftohtë të vitit dhe muajt më të lagët janë Nëntor-Dhjetor, Shëngjergji 263, 250mm, Biza 241, 203mm. Muaji më i thatë është Korriku 59 mm për dy vendmatjet meteorologjike. Në krahasim me vlerën mesatare të territorit shqiptar (1400mm) kjo zona renditet nën zonat e largëta të Shqipërisë. Duke pasur parasysh sasinë maksimale për 24 orë të reshjeve dhe intensitetin për intervale të ndryshme kohe në periudhë të ndryshme kthimi (return – period) kjo zonë karakterizohet nga një intensitet mesatar. Më Shëngjergj sasia e reshjeve më të madhe 24 orëshe nuk i kalon 160mm. Në bregun e djathtë përroi që buron nga qafa e Monumentit ndërsa në bregun e majtë përroi buron nga qafa e Rinasit rreth kuotës 898m. Ato bashkohen dhe formojnë fillimet e lumit Erzen që merr drejtimin për nga Perëndimi.

Zona në studim karakterizohet nga një regjim hidrografik tipik malor që manifestohet me gjithë intensitetin e tij me dimra të ashpër dhe me reshje të ndjeshme shiu dhe bora.

Reshjet në këtë zonë përgjithësisht shkojnë deri në 2000 m në vendmatjet meteorologjike Shëngjergj dhe Bizë. Në Shëngjergj në vitin 1966 kanë rënë 2300 mm sigurisht në kuotat më të larta të maleve që rrethojnë zonën në studim, reshjet janë akoma më të mëdha se ato të vrojtuar në vendmatjen meteorologjike.

Lartësia mesatare e pellgut ujembledhës mbi +1000m m.n.d. relativisht e madhe, pjerrësitë e shpateve në dy brigjeve dhe e shtratit të lumit të mëdha janë kushte të formimit të një rrjedhje të favorshme dhe nga reshjet e bollshme të shiut të borës.

Në këtë konfiguracion karakteristikat kryesore morfometrike të pellgut ujembledhës për Digen u përcaktuan me procedura të automatizuara në bazë të hartave topografike me shkallë 1: 25000.

Tabela nr. 2 Reshjet mujore dhe vjetore

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Shëngjergj	197	193	181	180	162	116	60	66	109	189	266	293	2012
Bizë	197	167	161	181	173	82	59	74	182	218	241	203	1940




Fig. 6 Reshjet mujore

2.3.2. Rreshjet maksimale

Tabela nr. 3 Reshjet më të mëdha 24 orëshe

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Max
Shëngjergj	159	112	108	65	118	79	59	68	98	128	135	96	159
Bizë	83	106	79	61	80	56	44	49	185	118	107	155	185

Tabela nr. 4 Intensiteti i reshjeve për intervale të ndryshme me siguri të ndryshme, Vendmatja Shëngjergj

Intervali kohor	Siguria në %				
	1	2	5	10	20
10`	36	32	29	25	22
20`	42	38	34	29	25
30`	48	43	38	34	29
1h	62	56	50	44	37
2h	80	72	64	56	48
3h	92	83	74	64	55
6h	118	106	90	83	71
12h	151	136	121	106	91

24h	195	176	156	137	117
-----	-----	-----	-----	-----	-----

2.4. Bora

Rënia e bores në këtë zone është dukuri e zakonshme për çdo vit . Kjo dukuri vërehet kryesisht në muajt e dimrit, megjithatë rënia e bores është vërejtur edhe në muajt Tetor dhe Prill. Numri i ditëve me bore në këtë pellg ujon ndryshon nga 80-90 ditë.

Lartësia mesatare maksimale e shtresës së borës ndryshon nga 90 deri në 100 cm. Lartësia maksimale e shtresës së borës ka arritur deri në 2 m.

Tab. 5 Disa të dhëna mbi shtresën e bores

Vendmatja	Numri maksimal i ditëve në vazhdim me shtresë bore	Numri mesatar vjetor i ditëve me shtresë bore	Lartësia maksimale e shtresës së borës, cm
Shëngjergj	35	29.1	98




Fig. 7 Harta e rreshjeve mesatare e debores

Tabela Nr. 6 Raporti i reshjeve më të mëdha dhe më të vogla vjetore

Vendmatja	Reshjet më të mëdha	Reshjet më të vogla	Raporti maks-min

	Reshjet mm	Viti	Reshjet mm	Viti	
Shengjergj	3490	1966	732	1952	4.64
Bizë	2300	1978	1180	1982	1.95

3.1. Topografia

Eshte bere topografia e plote e zones se. Per sa i perket pellgut ujembledhes eshte perdor harta topografike e shkalles 1:25.000.




Fig. 8 Harta Topografike e pellgut ujembledhes

**GRUPI I PROJEKTIMIT:
ZENIT & CO sh.p.k**